



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit / Opština Dragaš / Dragas Municipality



KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

Duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 2 shkronja (d), neni 40 paragrafi 2 pika (c) të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, neni 32.2 i Statutit të Komunës së Dragashit - 01 Nr.06-103/1 të datës 11.09.2008, Kuvendi i Komunës në Dragash në mbledhjen e mbajtur me datën 21.03.2024 pas shqyrtimit dhe votimit paraprak, miraton këtë:

VENDIM

Neni 1

Me këtë vendim miratohet raporti për zbatimin e Planit Komunal për Integritet për vitin 2023.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është raporti për zbatimin e Planit Komunal për Integritet për vitin 2023.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdeset Kryetari i Komunës në bashkëpunim me drejtorët e Drejtorive të komunës së Dragashit, Sektorët dhe koordinatorin e Planit për Integritet.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi që nga dita e miratimit dhe do të prodhoj efekt juridik, pasi të plotësohen kushtet e parapara konform neneve 81 dhe 82 të LVL-së.

KUVENDI I KOMUNËS - DRAGASH

01 Nr. 060/01-5932-1124

Dt. 21.03.2024

Kryesuesja e Kuvendit
Arijeta Skeraj





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš

01 Nr. Br. 069/01-5932-1/25
21.03 2025
Dragash - Dragaš



Republika e Kosovës

Republika Kosovo/Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality

RAPORTI PËR ZBATIMIN E PLANI KOMUNAL PËR INTEGRITET 2023

KOMUNA DRAGASHIT

Dragash, 2024

Hyrje

Në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe “Strategjinë Shtetërore Kundër Korrupsionit” të cilat obligojnë të gjitha institucionet të zhvillojnë dhe miratojnë planet e integritetit, Komuna e Dragashit, ka hartuar dhe Planin e Integritetit për periudhën Janar 2023 – Dhjetorë 2026.

Plani i integritetit është një mjet për vendosjen dhe verifikimin e integritetit të Komunës dhe është një proces i dokumentuar për të vlerësuar nivelin e cënueshmërisë së Komunës dhe ekspozimin e tyre ndaj praktikave jo etike dhe të korrupsionit. Plani është dokument operativ, që ofron masa të mbështetura tek rreziku për të arritur objektivat e integritetit të Komunës.

Plani rithekson përkushtimin e Komunës së Dagashit për të shtuar dhe fuqizuar kontrollet ekzistuese operative në të gjitha aktivitetet, duke u fokusuar në ofrimin e shërbimeve efikase, transparente dhe të orientuar kah qytetari. Plani përshkruan masat e bazuara në rreziq për arritjen e objektivave të Komunës dhe forcimin e sundimit të ligjit, si dhe vlerat dhe standardet profesionale.

PLANI PËR INTEGRITET

Plani për Integritet është një dokument strategjik dhe operativ që konsiderohet si një mjet i rëndësishëm për fuqizimin e integritetit institucional. Ky plan kuptohet si një respektim i drejtpërdrejtë i vlerave morale, standardeve profesionale dhe i rregullave të zbatueshme normative. Gjithashtu, plani ofron masa të mbështetura tek rreziku për të arritur objektivat e integritetit të Komunës.

SHËNOTJCA

Në këtë pjesë të dokumentit përshkruhet raporti i zbatimit të masave të parapara në matricën e Planit Komunal të Integritetit 2023 – 2026 për secilën Drejtori apo Sektor brenda komunës.

-RAPORTI 1 – DREJTIMI DHE MENAXHIMI

- PËRSHKRIMI I RREZIKUT

- Objektivat dhe prioritetet e zhvillimit të komunës të paqarta dhe jo transparente si dhe mos përfshirja e të gjitha fushave përkatëse për zhvillimin e komunës në Planin Zhvillimor.

VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT

- Plani Zhvillimor Komunal dhjetëvjeçar 2013-2023 i Komunës së Dragashit ka skaduar në fund të vitit për të cilin po raportojmë. Me qëllim të rritjes së transparencës dhe gjithëpërfshirjes së fushave dhe prioritetëve në planin e ardhshëm, Komuna e Dragashit është në konsultime të vazhdueshme me ministrinë përkatëse të Planifikimit Hapësinor, për të bërë harmonizimin e planit të ardhshëm zhvillimor me Planin Hapësinor, duke u fokusuar në përcaktimin e objektivave dhe prioritetëve që ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik dhe turistik të Komunës së Dragashit.

- PËRSHKRIMI I RREZIKUT

- Opinion publik negativ dhe humbja e besimit të publikut në punën e administratës komunale dhe Kuvendit Komunal për shkak të transparencës së pamjaftueshme.

- VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT

- Për të rritur transparencën dhe llogaridhënien, Komuna e Dragashit angazhohet që të gjitha dokumentet që janë në interes publik t'i publikojë në uebfaqen zyrtare të Komunës, duke përfshirë edhe aktivitetet politike, si dhe seancat e Kuvendit të Komunës bashkë me procesverbalet. Përmes zyrtarëve përgjegjës për Informim dhe Konsultime Publike, si dhe zyrtarit përgjegjës për Qasje në Dokumente Publike, Komuna ka rritur në vazhdimësi numrin e publikimeve të aktivitetëve publike, dokumenteve zyrtare për konsultim publik, si dhe ka ofruar qasje të plotë në dokumente zyrtare, bazuar në kërkesat e qytetarëve, organizatave apo institucioneve të caktuara.

- PËRSHKRIMI I RREZIKUT

- Mospërputhja dhe paqartësia e përgjegjësive në administratën komunale

VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT

- Me qëllim të eliminimit të paqartësive lidhur me përgjegjësitë në Administratën Komunale, përmes Vendimit të kryetarit të Komunës është themeluar Komisioni prej shtatë anëtarëve për hartimin e Rregullores për Organizimin e Brendshëm të Administratës Komunale, duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore, deri në dërgimin për miratim në Kuvendin e Komunës. Kjo Rregullore do të përcaktojë mënyrën e organizimit të brendshëm, përcaktimin e strukturës organizative, funksionimin dhe përgjegjësitë për zyrtarët, njësitë, zyrat, drejtoritë dhe të gjitha organet relevante për funksionimin e përgjithshëm dhe efikas të Administratës Komunale.

- PËRSHKRIMI I RREZIKUT

- Nuk ekzistojnë rregullat e brendshme në lidhje me papajtueshmërinë e funksionit dhe konflikti i interesit.
- **VEPRIMET/MASAT E NDERMARRURA NË ZVOGELIMIN E RREZIKUT**
- Për të parandaluar çfarëdo lloj të konfliktit të interesit, kryetari i Komunës ka marrë vendim që të caktojë zyrtarin përgjegjës për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, detyrë e të cilit është që të shmang çdo lloj konflikti potencial të interesit dhe të zbulojë menjëherë para autoritetit kompetent.

Ne këtë pjesë të dokumentit përshkruhet raporti i zbatimit të masave të parapara në matricën e Planit Komunal të Integritetit për secilën Drejtori apo Sektor të Komunës

RAPORTI 2 - NJËSIA E BURIMEVE NJERËZORE-KOMUNA E DRAGASHIT

PËRSHKRIMI I RREZIKUT

Mos plotësimi i vendeve të punës me staf adekuat dhe të mjaftueshëm.

VEPRIMET/MASAT E NDERMARRURA NË ZVOGËLIMIN E RREZIKUT

Mos plotësimi i vendeve të punës me staf adekuat, për institucionin paraqet një problem shumë serioz. Nga kjo anomali gjatë punës së institucionit kemi ngeçje në realizimin e objektivave. Institucioni jonë duhet të ketë prioritet të sajë parimin e meritokracisë –personi i duhur në vendin e duhur.

Për vitin 2023, plotësimi i Planit të Personelit është bërë në koordinim me kryetarin e Komunës, gjithmonë në përputhje dhe pajtim me ligjet dhe aktet nënligjore që rregullojnë këtë fushë. Pra, mund të themi se kemi rezultate të kënaqshme në këtë drejtim,

Të gjithë të përzgjedhurit gjatë procedurës së rekrutimit i kanë plotësuar kushtet dhe kriteret si për nga nivelin arsimor ashtu edhe në kuptimin e përvojës së punës, e po ashtu gjatë periudhës së punës provuese janë aftësuar në nivelin e kërkuar dhe konstatohet se zbatimi i parimit të meritës gjatë procedurave të punësimit është respektuar dhe të punësuarit janë në nivel të detyrës në të gjitha aspektet.

PËRSHKRIMI I RREZIKUT

Profesionalizmi dhe kompetenca e pamjaftueshme e të punësuarve.

VEPRIMET/MASAT E NDERMARRURA NË ZVOGËLIMIN E RREZIKUT

Të gjithë zyrtarët publik të administratës komunale në bazë të planit të trajnimeve, zhvillojnë trajnime në ngritje profesionale dhe specifike të fushës së tyre. Trajnimet kryesisht organizohen nga IKAP dhe Ministrinë e Linjave. Institucioni duhet të ndër marr veprime konkrete dhe me një punë profesionale të bëhet një Rregullore për Organizimin e Brendshme të institucionit. Me këtë rregullore se cili zyrtar i administratës komunale të ketë përshkrimin e detyrave të punës të cilat do të kryej.

Trajnimet e stafit kanë ndikim pozitiv, në ngritjen e profesionalizmit në kryerjen e detyrave me efikasitet dhe rezultate të larta.

PËRSHKRIMI I RREZIKUT

Përshkrimet e vendeve të punës të nëpunësve të pa qarta, jo adekuate dhe të pa përditësuar.

VEPRIMET/MASAT E NDERMARRURA NË ZVOGËLIMIN E RREZIKUT

Në lidhje me përshkrimet e vendeve të punës, aktualisht komuna e Dragashit ka formuar komision komunal përkatës për organizimin e brendshëm të institucionit komisioni do të punojë për organizimin e brendshëm në lidhje me klasifikimin, sistematizimin e vendeve të punës, duke u bazuar në LZP dhe rregulloren për klasifikimin e vendeve të punës me qëllim të riorganizimit të Administratës Komunale. Po ashtu së shpejti pritet të jetëshohet katalogu i ri i vendeve të punës.

Kohë pas kohe menaxheri i NJMBNJ organizon takime me personelin dhe diskutohet për mekanizmat e raportimit të korrupsionit dhe aktiviteteteve të paligjshme. Zakonisht nuk ka raportime për çështjet në fjalë.

PËRSHKRIMI I RREZIKUT

Dergimi i kodit komunal të etikës për të gjithë zyrtarët komunal përfshirë zyrtarët publik, të zgjedhurit dhe të emëruarit .

VEPRIMET/ MASAT E NDERMARRURA NË ZVOGLIMIN E RREZIKUT

Ç'do i punësuar në shërbimin civil dhe publik, me rastin e punësimit(njoftohet me kodin e etikës dhe ligjet zyrtare me të cilat ndërmjet tjerash flitet për të drejtat dhe detyrimet e të punësuarit ndaj Institucionit dhe shoqërisë, ndërsa të zgjedhurve kodin e etikës nuk i shpërmdahet, Në të ardhmen do punojmë që një gjë e tillë të realizohet në mënyrë që edhe të zgjedhurit të njoftohen me kodin e etikës

PËRSHKRIMI I RREZIKUT

Mungesa e informimit dhe sensibilizimi për ekzistencën e kodit të etikës për Stafin drejtues dhe stafin tjetër të komunës .

VEPRIMET/MASAT NDERMARRURA NË ZVOGLIMIN E RREZIKUT

Vazhdimisht bëhet sensibilizimi për ekzistencën e kodit të etikës për të gjithë stafin e komunës së Dragashit është publikuar edhe në ueb faqe të Komunës.

PËRSHKRIMI I RREZIKUT

Mungesa e informimit dhe mos raportimi i dhuratave nga qytetarët tek punëtorët

VEPRIMET/MASAT E NDERMARRURA NË ZVOGLIMIN E RREZIKUT

Mos raportimi i pranimit të dhuratave nga qytetarët për punëtorët e komunës ,mund të themi se kjo dukuri vazhdon me trendin e njëjtë pa ndonjë ndryshim. Parashihet që të bëhen disa takime me zyrtarët dhe njoftimi me procedurat që duhet ndjekur me rastin e pranimit të dhuratave nga palët.

PËRSHKRIMI I RREZIKUT

Niveli i pa mjaftueshëm i ndërgjegjësimit të punonjësve për raportimin e korrupsionit dhe aktiviteteteve tjera të pa ligjshme brenda institucionit

VEPRIMET/MASAT E NDERMARRURA NË ZVOGLIMIN E RREZIKUT

Komuna deri më tani nuk ka asnjë rast të raportuar për regjistrimin e dhuratave nga nëpunësit Në ardhmen do të bëhet sensibilizimi i të gjithë punonjësve lidhur me këtë dukuri

PËRSHKRIMI I RREZIKUT

Trajtimi jo adekuat i raporteve të paraqitura nga sinjalizuesi dhe mos mbrojtja e identitetit dhe të drejtave të sinjalizuesit.

VEPRIMET/MASAT E NDERMARRURA NË ZVOGLIMIN E RREZIKUT

Njësia e Burimeve Njerëzore ka theksuar se sa u përket sjelljes, etikes dhe profesionalizimit të punësuarve ,matrica e nivelit të rrezikut ka lëvizur drejtë përmirësimit të gjendjes së më parshme ,falë funksionalizimit të komisioneve të ndryshme.

Gjithsesi NJMBNJ ne kuadër të Komunës së Dragashit do të angazhohet për realizimin e të gjitha objektivave dhe çështjeve të cilat do të ndikojnë në rritjen e performances komunale në lidhje me integritetin e Komunës tonë.

-RAPORTI 3- PLANIFIKIMI DHE MENAXHIMI I BUXHETIT DHE FINANCAVE.

- PËRSHKRIMI I RREZIKUT

Planifikimi jo adekuat i buxhetit vjetor komunal

- VEPRIMET/MASAT E NDERMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT

Gjatë dëgjimeve buxhetore për planifikimin/hartimin e buxhetit vjetor komunal, janë respektuar dhe ndërmarr të gjitha masat konform ligjeve dhe rregulloreve në fuqi, me pjesëmarrje (qytetar, OJQ etj.) Po në të njëjtën kohë janë mbajtur edhe trajnime dhe takime nga ana e MFPT dhe organizatave tjera si: DEMOS, OSCE.

- PËRSHKRIMI I RREZIKUT

Shpenzimi i buxhetit jo në mënyrë adekuate dhe jo mjaftueshëm transparente

- VEPRIMET/MASAT E NDERMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT

Drejtoria për Ekonomi e Financa në baze të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi brenda afateve ligjore bënë hartimin dhe miratimin e raportimeve në baza tremujore, gjatëmuajore dhe vjetore, dhe publikimin e tyre në Ueb faqen komunale.

Komuna nuk ka krijuar komision të përbërë nga përfaqësuesit e komunës dhe OJQ - të për mbikëqyrje të jashtme mbi zbatimin e buxhetit, mirëpo në vazhdimësi kërkojnë raportin e shpenzimeve të bëra nga komuna në periudha të ndryshme. Gjatë mbledhjeve të bordit të drejtorëve, OSCE merr pjesë, aty diskutohet edhe për shpenzimin e buxhetit.

- PËRSHKRIMI I RREZIKUT

Inventarizimi dhe regjistrimi i aseteve komunale

- VEPRIMET/MASAT E NDERMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT

Inventarizimi i pasurisë bëhet çdo vit. Formohet komisioni i cili bënë inventarizimin dhe raporton për këtë procedurë, po ashtu është formuar komisioni për evidentimin dhe vlerësimin e pasurisë, dhe regjistrimi i pasurisë bëhet edhe në sistemin e-pasuria.

FUSHAT E VEÇANTA TE RREZIKUT

- RAPORT I- AUDITIMI I BRENDSHËM.

- VEPRIMET PER VLERESIMIN E RREZIKUT NGA NJAB (NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM) PER PLANIN E INTEGRITETIT

Njësia e Auditimit të Brendshëm ne vazhdimësi duke u bazuar në detyrat audituese të sistemeve brenda komunës bënë vlerësimin e rrezikut dhe funksionimin e kontrollës së brendshme gjatë vitit, ku në bazë të rezultateve të deri tanishme ka bërë edhe vlerësimin e masave të ndërmarra për evitim/ zvogëlimin e rreziqeve të parapara në fushën e auditimit të brendshëm në planin e integritetit të komunës 2023-2026.

FUSHAT E VEÇANTA TË RREZIKUT- AUDITIMI I BRENDSHËM

- PËRSHKRIMI I RREZIKUT

Mungesë e numrit të mjaftueshëm të auditorëve të brendshëm.

- VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRUNA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT

NJAB ka vepruar ashtu që ka njoftuar Zyrтарin Kryesor Administrativ (ZKA) që të ndërmerren veprime/masa lidhur me rekrutimin e burimeve njerëzore adekuate (sasi dhe cilësi) sipas Udhëzimit Administrativ QRK(Qeveria e Republikës së Kosovës) nr.01/2019 Për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm (neni 5, pika 1.1), Doracakut të Auditimit të brendshëm, Ligjit për kontroll të brendshme të financave publike 06/L021 dhe ligjeve tjera.

Kjo çështje është parashtruar nga NJAB edhe në Komitet të Auditimit të brendshëm (KAB), më q 'raste është mbështetur propozimi i rekrutimit të stafit në fjalë.

Si sfida mbeten për tu parë veprimet dhe masat e ndërmarra nga ekzekutivi.

- PËRSHKRIMI I RREZIKUT

Mungesa e hapësirës (Zyrës) së veçantë dhe përmirësimit të kushteve të punës.

- VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRUNA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT

NJAB ka kërkuar nga ZKA për t'iu siguruar hapësirë (Zyre) e veçantë dhe përmirësim i kushteve të punës , në mënyrë që të mbrohet nga rreziku i ndikimeve të jashtme auditimi i brendshëm, për mbrojtur sigurinë e personelit dhe dokumentacionit, pavarësinë në punë dhe auditime të paanshme dhe objektive,

NJAB ka parashtruar këtë si çështje e pazgjidhur në Komitetin e Auditimit të Brendshëm , të cilët kanë premtuar përkrahje dhe ndërmjetësim tek ZKA për tu siguruar hapësira (zyra) e veçantë dhe përmirësimi i kushteve të punë

Si sfida mbeten për tu parë veprimet dhe masat e ndërmarra nga ekzekutivi.

- PËRSHKRIMI I RREZIKUT

Mungesa e planifikimit të auditimit të bazuar në rrezik dhe auditimeve rast pas rasti

- VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRUNA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT

NJAB për vitin 2023 ka bërë Planifikimin Strategjik dhe Vjetor të auditimit të brendshëm të bazuar në rezultatet e vlerësimit të rrezikut dhe pikërisht duke u bazuar në këto analiza, duke u bazuar në standardet ndërkombëtare të auditimit, janë paraparë në planin e auditimit, detyrat audituese me rrezik të lartë, të mesëm dhe të ulët. Referencë është Plani Strategjik 2023-2025 dhe Plani Vjetor 2023.

- PËRSHKRIMI I RREZIKUT

Mungesa e mbikëqyrjes adekuate, profesionale mbi zbatimin e rekomandimeve

- VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRUNA ZVOGELIMIN E RREZIKUT

NJAB pas përfundimit të Auditimeve të brendshme përgatit Raportet e Auditimit të brendshëm, të cilat i dërgon në Drejtorin e audituar apo menaxherin e subjektit të audituar, nga ana e tyre janë përgatitur dhe dorëzuar (në formë fizike apo elektronike) planet e veprimit për implementimin e rekomandimeve.

Sfidë mbetet mosdorëzimi i planeve në afatin e përcaktuar nga NJAB dhe mos caktimi i qartë i afateve për zbatimin e rekomandimeve nga subjektet e audituara.

- PËRSHKRIMI I RREZIKUT

Mungesa e koordinimit ndërmjet Njësisë së AB, Kryetarit, drejtorëve të drejtorive dhe Komitetit të Auditimit,

- VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRUNA ZVOGELIMIN E RREZIKUT

NJAB me rastin e zhvillimit të aktivitetit të auditimit është në koordinim me ZKA (i cili në këtë rast është Kryetari i komunës) dhe KAB, duke ja filluar nga miratimi i planeve Strategjike dhe vjetore të NJAB.

NJAB është e koordinuar me Drejtorët, subjektet e auditimit pasi që Auditimet e brendshme i fillon duke :

- Njoftuar me kërkesë për datën e takimit fillestar me Drejtorët, Subjektet e auditimit;
- Mbahet takimi fillestar me subjektet e auditimit;
- Testimet në terren të subjektit të audituar;
- Draft Raportin ia dërgon subjekteve të audituara (Drejtorëve, e tj), për të mbajtur takimin përmbyllës dhe shqyrtim të Draft raportit për të përgatit planin e zbatimit të rekomandimeve, para se të finalizohet raporti i Auditimit;
- Raporti i finalizuar me komente apo plan veprimi të subjekteve të audituar, i dërgohet subjekteve të audituara, ZKA-Kryetarit dhe KAB.

Sfidë mund të jetë mosdërgjegjësimi apo keqkuptimi i rolit të auditimit të brendshëm nga subjektet e audituara.

- PËRSHKRIMI I RREZIKUT

Raportet e auditimit nuk i nënshtrohen kontrolleve të sigurimit të cilësisë

- VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRUNA ZVOGELIMIN E RREZIKUT

- Raportet e auditimit rishikohen para se te dorëzohen nga udhëheqësi i NJAB -se, duke u siguruar se te gjitha te gjeturat janë te bazuar ne dëshmitë e auditimit,;
- Raportet diskutohen me menaxhmentin, shqyrtohen ne Komitetin për Auditim të brendshëm pas finalizimit të tyre ;
- Në baza gjashtëmujorë raportohen në NJQHAB-MF , si dhe
- Të gjitha raportet e auditorit te brendshëm rishikohen nga Auditori i jashtëm.

- **RAPORT 2- PROKURIMI PUBLIK.**

Lidhur me pikat e raportit të planit të integritetit me të cilat është potencuar Zyra e prokurimit, Udhëheqësi i sektorit për prokurim bën këto sqarime shtesë:

- **PËRSHKRIMI I RREZIKUT**

Përgatitje joefikase e specifikimeve të tenderit

- **VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT**

- Specifikimet e marra nga të gjitha Njësitë e Kërkesave (Drejtoritë) duhet të jenë sa më profesionale dhe të përgatitura në përputhje me të gjitha ligjet në fuqi që kanë të bëjnë me këto specifikime (duhet të jenë profesionale, jodiskriminuese dhe transparente). Përgatitja efektive e specifikimeve të tenderit është çelësi për sukses më të mirë të zbatimit.

- **PËRSHKRIMI I RREZIKUT**

Mos transparenca dhe mbikëqyrja e pa mjaftueshme e prokurimit publik.

- **VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT**

- Me vet faktin se të gjitha veprimet dhe procedurat të cilat zhvillohen në Zyrën e prokurimit- kryhen përmes platformës së E-PROKURIMI, na tregon se këto veprime janë transparente, jodiskriminuese, profesionale dhe ligjërsh të pregaditura mirë.

- Në këtë platformën lejnë gjurmë të gjitha veprimet e zyrës dhe të njëjtat mund të shihen dhe verifikohen nga çdo pale e interes.

- **PËRSHKRIMI I RREZIKUT**

Menaxhimi joefikas i kontratave/projekteve dhe kontroll jo efikase e zbatimit të kontratave.

- **VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT**

- Pas nënshkrimit të kontratës nga Zyra e Prokurimit, menaxhimi i kontratës deri në përfundim të njëjtës kalon në njësinë e kërkesës, gjegjësisht te mbikëqyrësi drejtpërdrejt i menaxherit të kontratës dhe i menaxherit të kontratës të cilët janë të emëruar nga ZKA (kryetari i komunës). Kontrolli i rregullt në të gjitha fazat e zbatimit do të zvogëlojë rreziqet dhe do të kontribuojë në zbatimin më të mirë të kontratës.

-RAPORT 3- ZHVILLIMI EKONOMIK

- PËRSHKRIMI I RREZIKUT

Mungesa apo mos rishikimi dhe përditësimi i dokumenteve strategjike për zhvillim ekonomik lokal

- VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT

Komuna e Dragashit ka pasur Planin Zhvillimor Komunal dhjetëvjeçar 2013-2023. Në vitin raportues (2023) ky plan ka skaduar dhe Komuna ka ndërmarrë menjëherë procedurat e nevojshme për fillimin e hartimit të një plani të ri dhjetëvjeçar. Për të respektuar dispozitat ligjore në fuqi, Komuna ka bashkërenduar në vazhdimësi aktivitetet me ministritë përkatëse (MAPL dhe MIPHI) dhe është duke përgatitur Planin Strategjik për Zhvillim Ekonomik Lokal për vitin 2024 dhe Hartat Zonale. Me vendim të kuvendit mbesin në fuqi plani aktual për zhvillim ekonomik lokal dhe strategjia për zhvillim ekonomik lokal deri në miratimin e një plani të ri.

- PËRSHKRIMI I RREZIKUT

Qëllimet dhe prioritetet e zhvillimit ekonomik të komunës të paqarta dhe jo-transparente.

- VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT

Komuna e Dragashit, gjatë hartimit dhe zhvillimit të dokumenteve publike dhe strategjike që lidhen me zhvillimin ekonomik, synon që çdo herë t'i bëjë sa më të qarta dhe transparente qëllimet dhe objektivat e saj. Ndër qëllimet dhe prioritet kryesorë të Komunës që lidhen me zhvillimin ekonomik janë investimet në ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore në sektorin e turizmit, investimet në infrastrukturë rrugore për lehtësimin e qasjes në zonat turistike, si hapja, trasimi dhe asfaltimi i rrugëve që lidhin fshatrat me zonat turistike malore. Gjithashtu, këto investime ndikojnë edhe në lehtësimin e qasjes së fermerëve dhe bujqve nëpër pronat e tyre dhe rrit mundësitë për vetëpunësim, pasi që krijohen kushtet më të favorshme për zhvillimin e aktiviteteve bujqësore, blegtorale etj.

- PËRSHKRIMI I RREZIKUT

Kritere jo të qarta dhe transparencë e pa mjaftueshme në ndarjen e subvencioneve

- VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT

Komuna e Dragashit ka ndërmarr masat e nevojshme për zvogëlimin e rrezikut dhe për një transparencë sa më të madhe në ndarjen e subvencioneve si hartimi i rregullores së brendshme nr. 01Nr.060/01-31587/1 e që është në harmoni me rregulloren e ministrisë 04/2017 për ndarjen e subvencioneve e cila vlen për të gjitha komunat. Për ta evituar rrezikun komuna e Dragashit ka edhe komision për mbikëqyrjen e shpërndarjes së subvencioneve konforme rregullores.

- PËRSHKRIMI I RREZIKUT

Kualifikimi i pamjaftueshëm i personelit për hartimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të dokumenteve për zhvillimin ekonomik lokal

- VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT

Komuna e Dragashit ka bërë disa hapa shumë të rëndësishme për zvogëlimin e rrezikut në raport me mbikëqyrjen e planit zhvillimor pasi që ka punësuar një zyrtar për zhvillim ekonomik i cili bën mbikëqyrjen e dokumentacionit dhe mënyrën e zbatimit të tij.

- **PËRSHKRIMI I RREZIKUT**

Mbikëqyrja jo efikase mbi zbatimin e aktiviteteve të zhvillimit ekonomik lokal

- **VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT**

Mbikëqyrja, kontrollimi dhe raportimi i rregullt për zbatimin e aktiviteteve të zhvillimit ekonomik lokal është duke u bërë nga ana e zyrtarëve kompetent të kësaj komunës.

- RAPORT 4- URBANIZEM DHE PLANIFIKIM HAPËSINOR

PËRSHKRIMI I RREZIKUT

Mangësitë në rregulloret e brendshme lidhur me fushën e planifikimit urban dhe rural

VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT

Në përputhje me nismën legislative të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është në proces miratimi i Ligjit të ri për Planifikim Hapësinor, i cili do të rregullojë dokumentet tjera planifikuese që janë në juridiksionin e vetëqeverisjes lokale.

- PËRSHKRIMI I RREZIKUT –

Zbatimi jo i plotë i rregulloreve të brendshme në fushën e planifikimit urban dhe rural

VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT

Deri në miratimin e Ligjit të ri për Planifikim Hapësinor, të gjitha rregulloret e brendshme duhet të harmonizohen me Ligjin e ri ose të hartohen rregullore të reja të brendshme në mënyrë që të lehtësohet funksionimi i sektorit të planifikimit urban.

- PËRSHKRIMI I RREZIKUT –

Kualifikim i pamjaftueshëm i personelit për përgatitjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të dokumenteve të planifikimit urban dhe rural

VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT

Në përputhje me klasifikimin e pamjaftueshëm, Drejtoria ndërmori një sërë masash të nevojshme për punësimin e zyrtarëve të rinj, me qëllim hartimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të dokumenteve urbanistike.

- PËRSHKRIMI I RREZIKUT –

Mbikëqyrja joefikase e zbatimit të punimeve të planifikimit urban dhe rural (ndermarja mbikëqyrëse)

VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT

Meqenëse rregulloret e brendshme të planifikimit janë nga viti 2013 me afat vlefshmërie deri në vitin 2023, ku thuajse janë zbatuar, nevojitet një rregullore e re e brendshme e planifikimit, e cila duhet të zbatohet në periudhën në vijim.

-RAPORT 5- DREJTORIA PËR ARSIM

Në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe "Strategjinë Strategjore Kundër Korrupsionit" të cilat obligojnë të gjitha institucionet të zhvillojnë dhe miratojnë planin e integritetit, Komuna e Dragashit, ka hartuar dhe miratuar Planin e Integritetit për periudhën 2023 -2026.

Plani për Integritet është një dokument strategjik dhe operativ që konsiderohet si një mjet i rëndësishëm për fuqizimin e integritetit institucional. Ky plan kuptohet si një respektim i drejtpërdrejtë i vlerave morale, standardeve profesionale dhe i rregullave të zbatueshme normative. Gjithashtu, plani ofron masa të mbështetura tek rreziku për të arritur objektivat e integritetit të Komunës.

- PËRSHKRIMI I RREZIKUT

Planifikimi i shërbimeve arsimore jo adekuat dhe i pafektshëm

- VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT

DKA në Dragash është në fazën e planifikimit për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal për 2024-2027, i cili plan do të ketë objektivat dhe aktivitetet për shërbime arsimore sa më efikase dhe efektive për të gjitha IA

Arsimi në Dragash është sektor i rëndësishëm, si për rreza vëllimi i punëve dhe pjesëmarrja në buxhetin komunal, por edhe nga implikimet e mëdha që mund të ketë për shoqërinë. DKA- Dragash menagjon 36 objekte shkollore dhe atë 12 shkolla amë, 23 shkolla satelitet, 1 shkollë të mesme të lartë., përmes së cilave ofron shërbime për rreth 3041 nxënës dhe mbi 442 të punësuar në IA.

Në përgjithësi vlerësohet se cilësia e arsimit ka shënuar progres dhe është në nivel të mirë, por konsiderohet se ende ka nevojë për investime dhe përmirësimin e gjendjes së arsimit në shumë fusha e drejtime, andaj kërkohet një përqendrim më i madh i komunës së Dragashit në fushën e arsimit ne vitet vijuese.

- PËRSHKRIMI I RREZIKUT

Inspektimet e pa mjaftueshme të procesit mësimor

- VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT

DKA ka planifikuar që këtë vit shkollor vizitat të jenë më të shpeshta dhe për çdo shkollë që vizitohet të përpilohen edhe raportet kthyesë. Gjithashtu edhe drejtuesve të shkollave të ju jepen rekomandime nga të gjeturat.

- PËRSHKRIMI I RREZIKUT

Rekrutimi i stafit në sektorin e edukimit nuk është efikas

- VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT

Rekrutimi si procedurë ende mbetet një sfidë për institucionet arsimore në komunën tonë si dhe në komunat tjera, sfide me të cilën ballafaqohemi bashkë, kemi përplasje të Ligjeve ndërmjet Ligjit për Zyrtar Publik, Ligjit për Arsimin Parauniversitar, Ligjit për Arsim në Komuna dhe Ligjit të Punës.

- PËRSHKRIMI I RREZIKUT

Siguria e dobët fizike e shkollave

- **VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT**

- Kemi përmirësim të dukshëm në shkollat e Dragashit, ngase gati në të gjitha shkollat kemi kamera dhe siguri edhe patrullat e rregullta policore

RAPORT 6 – SHERBIME PUBLIKE

PËRSHKRIMI I RREZIKUT

Efikasiteti, efektiviteti, cilësia e transparencës nuk janë të kënaqshme në ofrimin e shërbimeve publike

VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT

Edukimi i punonjësve për masat dhe procedurat e sigurisë është çelësi për reduktimin e rrezikut. Kjo përfshin ndërgjegjësimin për sigurinë e informacionit, sigurinë fizike dhe aspekte të tjera relevante.

Bashkëpunimi me autoritetet përkatëse të sigurisë dhe shkëmbeni informacion mbi kërcënimet e mundshme për të përmirësuar sigurinë e përgjithshme.

Monitorimi dhe raportimi i rregullt i ngjarjeve të sigurisë për të mundësuar një reagim të shpejtë ndaj kërcënimeve të mundshme.

Drejtoria e Shërbimeve Publike gjatë vitit 2023 ka bashkëpunuar me këto institucione:

1. AME – Trajtime vjetore të departamentit të zjarri-kuq për të përmirësuar efikasitetin gjatë veprimit në raste emergjente dhe jashtëzakonshme,
2. AKK - Bashkëpunimi me Asociacionin e Komunave të Kosovës lidhur me përmirësimin e shërbimeve publike dhe zvogëlimin e ndikimit mjedisor të aktiviteteve tona,
3. KFOR - Bashkëpunimi me autoritetet e sigurisë për të shkëmbyer informacione rreth kërcënimeve të mundshme,
4. USAID - Bashkëpunimi me Agjencinë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar me theks në përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike,
5. JICA - Bashkëpunimi me Agjencinë Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar në lidhje me përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave dhe reduktimin e ndotjes së mjedisit,
6. GIZ - Bashkëpunimi me Agjencinë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar në lidhje me përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave.

PËRSHKRIMI I RREZIKUT

Menaxhimi i pamjaftueshëm i rrezikut në menaxhimin e mbeturinave

VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT

Menaxhimi i rrezikut në fushën e menaxhimit të mbetjeve është jashtëzakonisht i rëndësishëm për të parandaluar pasojat e mundshme negative për mjedisin, shëndetin e njeriut dhe komunitetin. Veprimet dhe masat që kemi marrë gjatë vitit 2023 për të reduktuar rrezikun e menaxhimit joadekuat të mbetjeve janë:

1. Zbatimi i planit të menaxhimit të mbeturinave komunale, i cili është në përputhje me ligjet dhe rregulloret për menaxhimin e mbeturinave dhe përfshin grumbullimin, transportin, ruajtjen dhe deponimin e mbeturinave.
2. Edukimi dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve: Zbaram një program edukimi dhe ndërgjegjësimi për fëmijët e shkollave të klasës së 6-të të shkollës fillore për deponimin e duhur të mbetjeve, riciklimin dhe reduktimin e sasisë së mbetjeve të krijuara.
3. Përmirësimi i gjendjes së deponisë nëpërmjet rregullimit të terrenit, mbulimit të mbetjeve me tokë për të parandaluar përhapjen e ndotjes, rrethimit të deponisë me fidanë për të parandaluar përhapjen e mbetjeve, si dhe rinovimin e sistemit të kullimit të ujërave të zeza, si dhe instalimi i një peshore kamioni për të monitoruar më tej sasinë e mbetjeve të depozituara dhe për të përmirësuar kushtet në vitet e ardhshme.

4. Korniza ligjore dhe rregullative: Ndryshimi dhe plotësimi i urdhëresës komunale për menaxhimin e mbeturinave, e cila pritet të shqyrtohet dhe miratohet nga Kuvendi Komunal gjatë tremujorit të parë të vitit 2024, e cila përcakton përgjegjësitë e të gjithë aktorëve në procesin e menaxhimit të mbeturinave, duke përfshirë kompaninë, pushtetin vendor dhe qytetarët.
5. Inovacionet dhe progresi teknologjik: Instalimi i peshoreve të kamionëve dhe monitorimi duke përdorur një sistem të veçantë elektronik që do të përmirësojë efikasitetin dhe do të zvogëlojë rreziqet në menaxhimin e mbetjeve.
6. Bashkëpunimi me komunitetin: Përfshirja e O. Q-ve lokale mjedisore në proceset vendimmarrëse dhe monitoruese për të siguruar menaxhim më të mirë dhe reduktim të rrezikut.

-RAPORT 7- KOMUNIKIMI ME PALË TË JASHTËM TË INTERESIT.

- PËRSHKRIMI I RREZIKUT

Mungesa e transparencës dhe konsultimeve me palë të jashtme të interesit gjatë hartimit të rregulloreve dhe buxheteve komunale.

- VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT

Komuna e Dragashit, përmes zyrtarit përgjegjës për Informim, gjatë vitit 2023 i ka zbatuar të gjitha procedurat ligjore të konsultimit publik të draft buxhetit, si dhe të të gjitha akteve dhe dokumenteve të tjera të cilat kanë qenë në proces të hartimit nga organet përkatëse komunale gjatë këtij viti. Për të ngritur nivelin e transparencës dhe komunikimit me palët e jashtme, si dhe për të lehtësuar qasjen e qytetarëve, organizatave, dhe palëve të ndryshme të interesit në dokumentet publike, zyra e IT-së dhe zyrtari përgjegjës për Informim kanë krijuar në uebfaqen zyrtare të Komunës dy rubrika të veçanta ("Konsultimet Publike" dhe "Takimet dhe Dëgjimet Publike/Buxhetore"), ku publikohen të gjitha njoftimet për konsultime publike, draft dokumentet për konsultim publik, procesverbalet dhe raportet. Sa i përket hartimit të draft buxhetit komunal, në pajtim me të gjitha dispozitat ligjore në fuqi, është përpiluar kalendari për organizimin e dëgjimeve buxhetore, janë publikuar njoftimet në uebfaqe dhe në Facebook-un zyrtar për mbajtjen e këtyre dëgjimeve nëpër lokalitetet e caktuara, si dhe janë mbajtur procesverbalet për secilin dëgjim buxhetor dhe të njëjtit janë publikuar brenda afateve të caktuara ligjore. Gjithashtu, në bashkëpunim me konsulentët e DEMOS-it, kemi hartuar Raportin e përgjithshëm për organizimin e dëgjimeve buxhetore, ku janë raportuar të gjithë hapat e organizimit dhe mbajtjes së këtyre dëgjimeve, duke përfshirë komentet, kërkesat dhe propozimet e qytetarëve, si dhe numrin e përgjithshëm të pjesëmarrësve. Për të qenë sa më efektiv komunikimi me qytetarët dhe palët e interesit, është shfrytëzuar edhe databaza për konsultime publike, për të targetuar grupe të ndryshme qytetare dhe përfshirjen e tyre në proces të konsultimeve publike. Në këtë kontekst, Grupi Punues për hartimin e buxhetit, përmes zyrtarit përgjegjës për Informim, përmes komunikimeve elektronike ka dërguar mbi 40 ftesa të personalizuara për grupe të ndryshme qytetare, përfshirë: OJQ, biznese, përfaqësues të organizatave rinore, anëtarë të Kuvendit të Komunës etj.

- PËRSHKRIMI I RREZIKUT

Mungesa e partneritetit me shoqërinë civile në fushën e antikorrupsionit dhe bashkëpunimit me komunitetin e bizneseve.

- VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT

Bashkëpunimi me shoqërinë civile, organizatat joqeveritare dhe mediat ka qenë ndër prioritetet kryesore, me qëllim të rritjes së efikasitetit të komunikimit në mes të organeve publike komunale dhe qytetarëve, sa i përket hartimit të politikave publike që janë në interes të përgjithshëm. Përmes zyrtarit përgjegjës për Informim dhe zyrtarit për Qasje në Dokumente Publike, Komuna e Dragashit ka zbatuar praktika të mira komunikimi dhe bashkëpunimi me shoqërinë civile, sa i përket çështjeve që lidhen me fushën e antikorrupsionit, duke qenë e hapur dhe llogaridhënese në ofrimin e qasjes në dokumente publike dhe informim të drejtë. Gjithashtu, është luajtur një rol shumë i rëndësishëm në ndërtimin e urave të komunikimit ndërmjet shoqërisë civile dhe komunitetit të bizneseve, ku Komuna ka ofruar të gjitha informacionet e nevojshme për OJQ-të e interesuar në mbështetjen e bizneseve lokale.

RAPORT 8- DREJTORIA PER GJEODEZI DHE KADASTER

- PËRSHKRIMI I RREZIKUT

- Mungesa e transparencës për përdorimin e dokumenteve

- VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT

Në periudhën paraprake, Agjencia Kadastrale e Kosovës ka krijuar një platformë elektronike për marrjen e dokumenteve kadastrale (online), dhe përmes mediave ka informuar për transparencën e përdorimit të tyre.

- PËRSHKRIMI I RREZIKUT

- Mungesa e kapacitetit të brendshëm të njësisë kadastrale.

- VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT

Në kornizën ZKK-Dragas, në përputhje me politikën e punësimit në vetëqeverisjen lokale, mungon një jurist i diplomuar për të punuar në hartimin e Vendimeve dhe përgjigjeve ndaj ankesave.

- PËRSHKRIMI I RREZIKUT

- Mungesa e ndërgjegjësimit për regjistrin kadastral

- VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT

Ka mungesë të vetëdijes, por për kadastrën e dixhitalizuar ndërgjegjësimi dalëngadalë po rritet.

- PËRSHKRIMI I RREZIKUT

- Mungesa e kapaciteteve brenda njësisë kadastrale.

VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT

Pikërisht për shkak të mungesës së kapaciteteve brenda njësive kadastrale, ekziston rreziku dhe mungesa e masave për reduktimin e tyre.

- PËRSHKRIMI I RREZIKUT

- Mekanizmat e kontrollit nuk janë të mjaftueshëm

VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT

Nuk mjaftojnë sepse ZKK është e lidhur vertikalisht me KKA.

- PËRSHKRIMI I RREZIKUT

- Mungesa e koordinimit dhe komunikimit brenda njësive kadastrale

VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT

Mungesa e madhe e komunikimit dhe koordinimit mes ZKK-së dhe KKA-së.

-RAPORT 9-DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT.

PËRSHKRIMI I RREZIKUT

OJQ-të dhe organizatat sportive nuk zgjidhen rregullisht

- VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT

Ekzistojnë procedura dhe aplikohen nga komisionet për përzgjedhjen e OJQ-ve të cilat veprojnë në fushën e kulturës, rinisë e sportit bazuar në rregulloren komunale për ndarje të subvencioneve.

- PËRSHKRIMI I RREZIKUT

- a. Plani një vjeçar i punës së DKRS, me objektivat dhe dikastere
- b. Avancimi i bashkëpunimit me OJQ

- VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT

- a. DKRS çdo vit harton planin vjetor i cili shqyrtohet dhe miratohet nga Asambleja Komunale në kuadër të të cilit parashihen edhe objektivat që duhet të arrihen me rastin e implementimit të aktiviteteve kulturore, rinore e

sportive.

- b. Në kuadër të avancimit dhe bashkëpunimit, DKRS siguron mjetet financiare nga kategoria e subvencioneve për OJQ-të dhe ofron infrastrukturën me objekte dhe hapësira për zhvillim të aktiviteteve.
- Duke marrë parasysh nevojat dhe kërkesat e OJQ-ve në raport me vlerat qytetare e kulturore të qytetit të komunës tonë në vazhdimësi ka pasur angazhime në rritjen e buxhetit për subvencionim të organizatave. Një bashkëpunim i tillë ka ngritur në nivele më të larta jetën sportive, kulturore dhe rinore në Komunën e Dragashit dhe në të njëjtën kohë ka ngritur nivelin e funksionimit në dikasterin tonë.

- PËRSHKRIMI I RREZIKUT

Mungesa e kapaciteteve profesionale e punëdhënësve sportiv

- VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT

DKRS, nga kategoria e subvencioneve ka ndarë mjete financiare për klube sportive (OJQ) edhe sa i përket fushave të avancimit dhe përgatitjes profesionale të punëdhënësve sportiv. Krahas kësaj DKRS në vazhdimësi investon në infrastrukturë në ndërtimin e stadiumeve të reja dhe mirëmbajtjen e atyre ekzistues ku përfshihen: Ndërtimi i stadiumit të qytetit në Dragash, ndërtimi i stadiumit në Blaç e Pllavë si dhe palestra sportive në Brodosanë.

- PËRSHKRIMI I RREZIKUT

Numri i pamjaftueshëm i programeve të integritetit, etikës dhe pajtueshmërisë për të rinj

- VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT

DKRS përmes subvencioneve ka financuar programe për avancimin dhe fuqizimin e grupeve rinore në Komunën e Dragashit. Si rezultat i këtij bashkëpunimi me Organizatat rinore në komunën tonë janë implementuar disa programe për të rinj si:

- Programit Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor 2 që mbështetet financiarisht nga Bashkimi Evropian, Komuna e Dragashit dhe zbatohet nga UNDP (ReLOaD 2).
- Hapja e TECH HOUSE-it në Komunën e Dragashit, një shkollë digjitale e mbështetur nga Ambasada Amerikane në Kosovë së bashku me Komunën e Dragashit e që implementohet nga Qendra Rinore "AVOKO".
- Është hartuar plani i veprimit komunal për rini.

- **RAPORT 10-DREJTORIA PËR BUJQËSI, ZHVILLIM RURAL DHE INSPEKTIVE**

- **PËRSHKRIMI I RREZIKUT**

Kritere jo te qarta dhe transparence e pamjaftueshme në ndarjen e subvencioneve në zhvillimin e bujqësisë dhe sektorëve tjerë

- **VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT**

Respektimi i rregullores komunale ne fuqi për ndarjen e subvencioneve komunale, po ashtu gjatë hapjes se thirrjesë publike për aplikim te subvencioneve komunale jemi kujdesur qe sa me shumë të promovohen kriteret për aplikim duke shfrytëzuar rrjetet sociale, web te komunes, promovim ne media lokale etj. Por, në nivel komunal është ne procedur Rregullores e Re për ndarjen e subvencioneve komunale, në veçanti edhe ndarja e subvencioneve ne bujqësi, në të cilën përcaktohen qartë kriteret te cilat duhet përmbushur secili aplikues.

- **PËRSHKRIMI I RREZIKUT**

Mungesa e vetëdijesë për rreziqet ne sektorin e bujqësisë dhe pylltarisë

- **VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT**

Janë organizuar sesione trajnuese për fermerët për menaxhimin e rreziqeve ne bujqësi nga faktor te ndryshëm.

- **PËRSHKRIMI I RREZIKUT**

Kontrolli jo efikas mbi zbatimin e shërbimeve te zhvulimit te përdorimit te tokave

- **VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT**

Nuk ka përmirësime konkrete, kemi mungesë te stafit-konkretisht kemi mungesë te inspektorëve te bujqësisë qe merren në mbrojtje te tokës bujqësore.

- Pasi qe kemi nje numër te vogël te inspektorëve nuk kemi ndonjë plan per inspektive, inspektimet planifikohen ne bazën e nevojës dhe kërkesës se gjendjes ne terren, inspektimet te cilat kërkohen nga ministria e shendetsis, ambientit etj si dhe inspektimet rutinore.

- Koment; kemi munges te logjistikes si automjet per teren, shiritat per izolimin e vendit, mjete tjera logjistike per kryerjen e detyrave.

- **PËRSHKRIMI I RREZIKUT**

Mungesa e kapaciteteve profesionale të inspektorëve.

- **VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT**

Organizimi i trajnimeve, funksionimi i shërbimit së inspektionit pa zyrtar ligjorë,

- **PËRSHKRIMI I RREZIKUT**

Numër i pamjaftueshëm i inspektorëve

- **VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT**

- Të sigurohet numër i mjaftueshëm i inspektorëve nga personeli i brendshëm i komunës ose punësime të reja. Koment: Komuna jon momentalisht ka vetëm tre inspektor nga fusha komunale, ndërtimit dhe treut, qe eshte numër shum i vogël i inspektorëve.

- **PËRSHKRIMI I RREZIKUT**

Mungesa e kontrolleve mbi operatorët ekonomik

- **VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT**

- Numër i vogël i inspektorëve, mundësia e gabimeve gjatë marrjes së masave ndëshkuese nga ana e inspektorëve, përfaqësim i lëndëve në gjykata etj.

- **PËRSHKRIMI I RREZIKUT**

Mungesa e transparencës për punën e njësisë së inspektionit

- **VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT**

- Departamenti i inspektionit rregullisht ka dërguar raportin vjetor te punëve pran drejtorit te inspektionit lidhur me punët dhe detyrat qe i kanë kryer për vitin kalendarik, ku secili inspektor raporton veq e veq për punët dhe detyrat qe i ka kryer dhe dërgon raport ne formë te shkruar tek drejtori i inspektionit.

-RAPORT 8- DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Bazuar në Planin e integritetit të Komunës së Dragash, përkatësisht në implementimin e hapave në fushën e uljes së rreziqeve për disa çështje që janë parashikuar në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe mirëqenies sociale komuna e Dragashit, ju njoftoj me të dhënat e mëposhtme:

- **PËRSHKRIMI I RREZIKUT**

Hapësira dhe infrastruktura joefikase në ofrimin e shërbimeve shëndetësore

- **VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT**

Janë bërë investime në infrastrukturën shëndetësore për ofrimin e shërbimeve shëndetësore si ne QKMF por edhe atë të AMF-ve.

Këto investime janë bërë si në ofrimin e shërbimeve emergjente shëndetësore (Emergjencia e QKMF-së Dragash), Investime në Laboratorin e Analizave (QKMF- Dragash, dhe AMF -ve).

- **PËRSHKRIMI I RREZIKUT**

Mangësi në rregullativën e brendshme për ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe zbatimin jo i plotë i saj

- **VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT**

Janë mbajtur takime të kohëpaskohshme lidhur me diskutimin dhe sensibilizimin e stafit lidhur me respektimin dhe zbatimin e rregullatës në fuqi.

Janë mbajtur trajnime në fushat sociale ku janë të përfshira edhe rëndësia e zbatimit të rregullativave.

- **PËRSHKRIMI I RREZIKUT**

Mungesa e transparencës në punë

- **VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT**

Të gjitha shpalljet për përfitime sociale janë shpallur në faqe të Komunes si dhe janë shpërndarë përmes rrjeteve sociale.

Vendimet e propozuara nga Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale janë publikuar në ueb faqe të Komunes.

Janë ofruar informata si dhe statistika të institucionet kërkuese.

Është lejuar qasja në të dhëna sipas ligjit për dokumentet e kërkuara zyrtare.

- **PËRSHKRIMI I RREZIKUT**

Resurset humane me mangësi të mëdha në QPS.

- **VEPRIMET/MASAT E NDERRMARRURA NE ZVOGELIMIN E RREZIKUT**

Gjatë kësaj periudhe janë përmirësuar gjendja pasi që është bërë punësimi i stafit shtesë në drejtoratin për mirëqenie sociale ku janë punësuar 3 zyrtar dhe kemi konkurse të hapura për plotësimin e vendeve të reja të punës në QPS Dragash

01-Nr. 060/01-5932-1124

Datë 21.03.2027

Kryesuesja e Kuvendit



A. Skeraj
Arijeta Skeraj